



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 231/4 Prot.

Vlorë më, 12. 02. 2021

VENDIM

Nr. 10, datë 08. 02. 2021

**MBI KËRKESAT INDIVIDUALE TË PARAQITURA PRANË BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

Në mbështetje të nenit 49, të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 25 pika 2, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Vendimit nr. 45, datë 37. 09. 2019 "Për materialet e paraqitura pranë Bordit të Administrimit", të Bordit të Administrimit, shkresës nr. 129 prot, datë 13. 01. 2021, në mbledhjen e datës 08. 02. 2021 Bordi i Administrimit,

**VËREN SE:**

Pranë Bordit të Administrimit është paraqitur për shqyrtim kërkesa nr. 129 prot, datë 13. 01. 2021 e studentit Lavdie Karafili, dega Master i Shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare, e cila pretendon reduktimin e tarifës së shkollimit. Bordi i Administrimit vë re se, shkresa në fjalë e cila kërkon miratimin e BA është paraqitur si kërkesë individuale dhe nuk është e shoqëruar nga materiale shoqëruese nga strukturat përkatëse të cilat përgjigjen për natyrën e shkresës dhe problematikës që ajo paraqet. Në rastin në fjalë si dhe për kërkesa të tjera individuale, në të cilën kërkohet vendimarrje nga ana e Bordit të Administrimit kërkesat duhet t' i drejtohen edhe Administratorit të UV-së si autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar i cili përmes Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse të llogarisë efektin financiar dhe më pas kjo të përcillet pranë Bordit të Administrimit me propozim dhe relacion nga Administratori.

Në mbështetje edhe të Udhëzimit nr. 27, datë 29. 12. 2017 "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet e arsimit të lartë", pika 18 "Strukturat juridike, burimeve njerëzore, arkiv-protokollit dhe teknologjisë së informacionit në nivel institucioni apo njësie kryesore, ushtrojnë veprimtarinë e tyre në funksion të të gjitha strukturave në institucion". Vendimit nr. 45, datë 37. 09. 2019 "Për materialet e paraqitura pranë Bordit të Administrimit", Administratori kërkon mbështetjen nga drejtoritë dhe strukturat e tjera sipas natyrës së kërkesave të paraqitura.

Bordi i Administrimit e mbështet dhe e inicion vendimarrjen e tij në mbështetje të shkresave propozuese të ardhura nga autoritetet drejtuese të UV-së, pasi të kalojnë të gjitha hallkat institucionle lidhur me ndjekjen e problematikave të paraqitura në kërkesat individuale. Sa më sipër Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 08. 02. 2021,





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
BORDI I ADMINISTRIMIT

VENDOSI

1. Për çdo rast të kërkesave individuale, para se të kalojë për shqyrtim pranë Bordit të Administrimit, në mbështetje të të gjitha akteve ligjore në fuqi t' i përcillen edhe Administratorit.
2. Administratori përmes Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse të llogarisë efektin financiar dhe të përgatisë relacionin përkatës për tu paraqitur në Bordin e Administrimit.
3. Administratori në mbështetje edhe të Udhëzimit nr. 27, datë 29. 12. 2017 "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet e arsimit të lartë, Vendimit nr. 45, datë 37. 09. 2019 "Për materialet e paraqitura pranë Bordit të Administrimit", në çdo rast kërkon mbështetje nga Drejtoritë ose Sektorët përkatës sipas natyrës së problematikës të paraqitur.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Dr. Ervis MOCKA**